REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. 554 Prot. Tiranë, më 18.02.2026

**VENDIM**

Nr 54 datë 18.02.2026

**"PËR**
**PËRCAKTIMIN E POZICIONEVE PJESË E SHËRBIMIT CIVIL QË DO TË SHPALLEN PËR VITIN 2026, PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË"**

Në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", si dhe Vendimit të Kuvendit nr. 116/2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 28/2020 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar

**V E N D O S A:**

1. Pozicionet pjesë e shërbimit civil që do të shpallen për vitin 2026, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", janë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

**Artur Metani**

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr. 13, Tiranë Tel: + 355 4 2217217 http://www.ild.al info@ild.al

**Lidhja 1**

## PLANI VJETOR I PRANIMIT PËR VITIN 2026, PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

| NIVELI I LARTË DREJTUES | | | |
|---|---|---|---|
| *NR.* | *POZICIONI* | *NUMRI I POZICIONEVE VAKANTE* | *KLASA E PAGËS* |
| 1 | Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike dhe Integrimit | 1 | I-4 |
| **NIVELI I MESËM DREJTUES** | | | |
| *NR.* | *POZICIONI* | *NUMRI I POZICIONEVE VAKANTE* | *KLASA E PAGËS* |
| 1 | Ndihmësinspektor, Njësia e Ndihmësinspektorëve | 1 | II-1 |
| 2 | Drejtor, Drejtoria e Integrimit, Analizës dhe Monitorimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike dhe Integrimit | 1 | II-1 |
| 3 | Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse | 1 | II-2 |
| **NIVELI EKZEKUTIV** | | | |
| *NR.* | *POZICIONI* | *NUMRI I POZICIONEVE VAKANTE* | *KLASA E PAGËS* |
| 1 | Specialist në Sektorin e Hartimit të Akteve dhe Përputhshmërisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Juridike dhe Integrimit | 1 | IV-1 |